

KDU: 65: 34(05)



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

BIZNESI

Revistë shkencore për çështje

Ekonomike,

Juridike,

Emergjence e sigurie

Scientific journal on issues

Economic,

Law,

Emergency and security

Viti -X-

Nr. 20-21

**Punimet e Konferencës së 12-të Shkencore
Proceedings of the 12th Scientific Conference**

Prishtinë, 2020

BIZNESI

Revistë për çështje teorike e praktike të shkencave ekonomike, juridike, të
emergjencave dhe të sigurisë
Viti -X-, nr. 20-21, 2020

Botues - Editor

Kolegji BIZNESI - College BIZNESI

Këshilli botues - Editor council

Prof. dr. Musa LIMANI, kryetar

Prof. dr. Kudusi LAMA, anëtarë

Dr. sc. Xhevat BERISHA, anëtarë

Redaksia - Editors

Prof. dr. Reshad KADRIU, Prof. dr. Shyqeri KABASHI

Prof. dr. Kemajl RAMADANI, Prof. dr. Kudusi LAMA,

Prof. dr. Sabahudin KOMONI, Dr. Sc. Artan NIMANI

Kryeredaktor - Editor in chief

Prof. dr. Musa LIMANI

Sekretar i Redaksisë - Editorial Secretary

Mr. sc. Halim KULIQI

Redaktor gjuhësor - Linguistic editor

Prof. dr. Emin Kabashi

Disenjator - Design

Liridon Zekaj

Përmbajtja

Dr. Nexhmije KABASHI

Ma. Abetare KABASHI

Dr. Shyqeri KABASHI

Pasojat e COVID - 19 në bizneset e grave.....5

Dr. Kudus LAMA

Veçoritë dhe kërkesat e menaxhimit të emergjencave në kushtet e pandemisë 12

Dr. Sc. Besim KELMENDI

Infrastruktura ligjore në Kosovë për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse në kohë pandemie COVID - 19.....32

Dr. Muhamet Racaj

Dr. Nenad Taneski

Siguria njerëzore vs Bioterrorizmi si formë e kërcënimit hibrid48

Dr. Lulzim Farizi

COVID-19, zbrazëtira ligjore dhe shkelja e të drejtave të punëtorëve me theks të veçantë në RMV77

Ibrahim MALA, PhDc

Matja e rrezikut përmes metodës VaR në Kompanitë e Sigurimeve.....82

Milazim SHABANI

Hysnije METUSHI-SHEHU

Zamir DAMANI

Menaxhimi i shërimit të infektuarve me COVID-19 me plazëm të gjakut.....93

Dr. Shpetim Rezniqi

Përvojat e vendeve të zhvilluara në vlerësimin dhe menaxhimin e situatës së pandemisë 102

Arben AGUSHI

E drejta e sigurimeve në unionin evropian 107

Msc. Blerina HASANI

Burim KELMENDI

Veçoritë e menaxhimit të emergjencave në kushtet e Pandemisë COVID-19 dhe rrugët e vendosjes së normalitetit..... 116

Dritan TOPI Ismet BEQIRAJ COVID-19 dhe transporti në Shqipëri, hidrokarburet fosile dhe emetimet e CO2	124
Mr. Rrahman SEFEDINI Atdhe KABASHI Ndikimi i fatkeqësive në zhvillimin e biznesit në disa shtete.....	131
Dr. Urim VEJSELI Mekanizmat ndërkombëtarë për ndihmë humanitare	142
Dr. Brikenda VOKSHI Dr. Ariana XHEMAJLI Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ekonominë e Kosovës dhe atë globale.....	154
Arben HALILI Milazim SHABANI Menaxhimi i pandemisë COVID-19 në komunën e Ferizajt	163
Ma. Xhemajl JASHARI Vështrime juridiko - penale të veprës penale të vjedhjes së rëndë si dhe vështrime krahasuese të veprës penale të vjedhjes së rëndë në legjislacionin penal të Kosovës dhe disa vendeve në rajon	171
Dritan TOPI Zamir DAMANI Milazim SHABANI Ushqimi në kohën e pandemisë COVID-19, një krizë brenda krizës.....	191

Dr. Muhamet Racaj

Dr. Nenad Taneski

SIGURIA NJERËZORE VS BIOTERRORIZMI SI FORMË E KËRCËNIMIT HIBRID

(Human security vs Biotherorism as a form of a hybrid threat)

Abstract

The end of the Cold War opened a new chapter in the theory and practice of world international relations. The vocabulary of world politics and security itself has acquired a large number of new notions, which so far have either not been used or have been of marginal importance. One of these new notions is human security. At the core of this notion is the idea that the object of reference of security policy should be the individual, and not the state or the nation.

Although the idea of human security in the form, in which it is spoken today, was created in the nineties of the twentieth century, since ancient times there has been the idea that the political community above all is obliged to protect its citizens. This paper will provide a historical overview of the relationship between the state and human security. This will be followed by a discussion of the contemporary meaning of the term human security, as well as the criticisms it faces.

State actors constantly strive to become more powerful, while non-state actors seek their citizenship or recognition of their activities. For the realization of their ambitions, non-state actors challenge the West and its institutions and pose hybrid threats to their security. Dealing with hybrid threats means the synchronized use of military and non-military means against the specific

weaknesses of the adversary. If not detected and analyzed in a timely manner, it will move from dealing with hybrid threats to hybrid warfare. In the third part of the paper, bioterrorism will be reviewed as a form of hybrid threat in order to endanger human security.

Key words: human security, hybrid threat, hybrid warfare, bioterrorism

Abstrakt

Fundi i Luftës së Ftohtë hapi kapitull të ri në teorinë dhe praktikën e marrëdhënieve botërore. Vetë fjalori i politikës dhe sigurisë botërore, ka fituar një numër të madh të nocioneve të reja, të cilat deri tani ose nuk janë përdorur ose kanë qenë me rëndësi marginale. Një nga këto nocione të reja është siguria njerëzore. Në thelbin e këtij nocioni është ideja se objekt referimi i politikës së sigurisë duhet të jetë individi dhe jo shteti apo kombi.

Edhe pse ideja për sigurinë njerëzore në formën në të cilën flitet sot është krijuar në vitet e nëntëdhjeta të shekullit XX, që nga kohët e lashta ka pasur ide se bashkësia politike mbi të gjitha është e detyruar të mbrojë qytetarët e saj.

Do të bëhet një vështrim historik i marrëdhënieve midis shtetit dhe sigurisë njerëzore. Pas kësaj, një diskutim për kuptimin bashkëkohor të nocionit të sigurisë njerëzore, gjegjësisht për sigurinë e individit, si dhe kritikën me të cilat ky nocion është përballur.

Aktorët shtetëror vazhdimisht përpiqen të bëhen më të fuqishëm, ndërsa aktorët jo-shtetërorë kërkojnë shtetësi të tyre ose njohjen e aktiviteteve të tyre. Aktorët jo-shtetërorë për realizimin e ambicieve të tyre e sfidojnë Perëndimin dhe institucionet e saj dhe paraqesin kërcënime hibride për sigurinë e tyre. Ballafaqimi me kërcënimet hibride nënkupton përdorimin e sinkronizuar të mjeteve ushtarake dhe jo-ushtarake kundër dobësive specifike të kundërshtarit. Në qoftë se nuk zbulohen dhe analizohen në kohë, nga ballafaqimi me kërcënime hibride do të kalohet në luftimin hibrid.

Në pjesën e tretë do të bëhet shqyrtimi i bioterrorizmit si formë e kërcënimit hibrid në funksion të cenimit të sigurisë njerëzore.

Fjalët kyçe: siguria njerëzore, lufta hibride, bioterrorizmi

Hyrje

Fundi i Luftës së Ftohtë hapi kapitull të ri në teorinë dhe praktikën e marrëdhënieve botërore. Vetë fjalori i politikës dhe sigurisë botërore, ka fituar një numër të madh të nocioneve të reja, të cilat deri tani ose nuk janë përdorur

ose kanë qenë me rëndësi marginale. Një nga këto nocione të reja është siguria njerëzore. Në thelbin e këtij nocioni është ideja se objekt referimi i politikës së sigurisë duhet të jetë individi, dhe jo shteti apo kombi. Individi është njësia më e vogël për të cilën nocioni i sigurisë mund të reduktohet. Që nga shekulli XVII e deri në kohët bashkëkohore, shteti është treguar se është forma më e fuqishme e organizimit politik, si dhe garancia më e fortë e sigurisë së individit. Megjithatë, paradoksi i shtetit qëndron në faktin se, edhe pse shteti ekziston për të mbrojtur sigurinë individuale, ai shpesh herë paraqitet si burim më i madh i kërcënimeve për individët. Kjo është arsyeja pse shumë autorë, sidomos anëtarët e të ashtuquajturës, “shkolla e të menduarit kritik në studimet e sigurisë”, sygjerojnë se qëllimi i studimeve të sigurisë nuk duhet të jetë siguria kombëtare, por emancipim i njeriut. Në suazat e këtij opinionit, në vitet e nëntëdhjetë të shekullit XX, në kuadër të Kombeve të Bashkuara, është paraqitur nocioni “siguria njerëzore”, i cili si nocion pak më i ri, ka ndikuar fort mbi teorinë dhe praktikën e sigurisë botërore.

Megjithatë, siç do të tregohet, bëhet fjalë për ide kontraverse se nuk ekziston konsensus mes shkencëtarëve dhe bartësit e vendimeve politike në lidhje me përdorimin dhe kuptimin e vlerave. Ajo që nuk është kontestuese, është nocioni normativ që nuk shërben vetëm për analizën e politikave, por edhe për propozimet praktike politike. Bazat e sigurisë njerëzore janë jeta, të drejtat e njeriut dhe zhvillimi njerëzor, si dhe vlerat pozitive që politika e sigurisë duhet ti mbroj. Ajo gjithashtu është nocion gjithëpërfshirës që synon të lidhë një numër të madh të temave që janë vëzhguar më parë veçmas, të tilla si zhvillimi ekonomik, të drejtat e njeriut, ndryshimet klimatike, operacionet paqeruajtëse, siguria kombëtare, ndërtimi i shtetit, etj.

Nga pikëpamja e politikës vendore për sigurinë njerëzore dhe ideja se shteti kryesisht ka për detyrim të mbroj qytetarët e vet, nuk paraqet risi të madhe. Në të kundërtën, kjo ide gjendet në bazat historike dhe teorike të shtetit bashkëkohor.¹ Më konkretisht, gjatë shekullit XX, nocioni i sigurisë botërore ka qenë i lidhur me interesat kombëtare, “politikat e larta”, rendi ndërkombëtarë dhe marrëdhëniet mes fuqive të mëdha. Me zhvillimin e nocionit të sigurisë njerëzore në sigurinë botërore fillon të lidhet me diskutet e zhvillimit njerëzor dhe të drejtave të njeriut.

1 Ejuds F., *Megunarodna Bezbednost: Teorije, Sektori i Nivoi*, Beograd, 2012.

1. Historia e marrëdhënieve mes shteteve dhe siguria njerëzore

Edhe pse ideja për sigurinë njerëzore në formën në të cilën flitet sot, ishte krijuar në vitet e nëntëdhjeta të shekullit XX, që nga kohët e lashta ka ekzistuar ideja se bashkësia politike kryesisht është e detyruar të mbroj qytetarët e saj.² Për luftën e Peloponezitet, Tukididi shkroi se si grekët para zhvillimit të qyteteve-shtete mbanin armë për zhvillimin e këtyre poliseve.³ Në Politikë, Aristoteli shkruan se Poliset janë krijuar që të bëjnë “jetën të thjeshtë”, dhe të mbijetojnë për hir të “jetës më të mirë”.⁴ Madje edhe në traditën romake, ekzistonte besimi se sundimtari ka detyrime vetëm ndaj atyre që ai i sundonte. Perandoria Romake në mesjetën e hershme e zëvendësoi sistemin feudal me sistem të decentralizuar të qeverisjes në të cilin, nga njëra anë garonin Papa dhe perandori dhe nga ana tjetër, nivelet e ndryshme të pushtetit laik. Shteti, si në kuptimin e lashtë ashtu edhe në atë modern, nuk ekzistonte për detyrimin e tij për të mbrojtur qytetarët e vet. Qeverisja gjatë “kohës së errët” legjitimitetin e merrte nga mandati i Perëndisë dhe jo nga mbrojtja që e ofrojnë subjektet e tij.

Me zhvillimin e shtetit sovran në shekullin XVII, i cili u zhvillua paralelisht me doktrinat e sovranitetit absolut monark dhe arsytet shtetërore, u zhvillua edhe teoria shoqërore. Sipas kësaj teorie, themelues i së cilës është Thomas Hobbes, individët me sovranin lidhën një marrëveshje në të cilën transferuan sovranitetin në këmbim për mbrojtjen e sigurisë së tyre personale. Gjatë shekullit XIX, nacionalizmi ka krijuar ide organike të komunitetit politik, në të cilin kolektivi gjithmonë është para individit. Kjo ide organike e komunitetit, kulmin e saj e arriti në Luftën e Parë Botërore. Paralelisht me këtë, shtetet kombëtare Evropiane ishin gjithnjë e më të shqetësuar për të drejtat, jo vetëm të qytetarëve të tyre, por edhe të qytetarëve të vendeve të tjera. Në Kongresin e Vjenës, të mbajtur në vitin 1815, u ndërpre skllavëria në Evropë dhe gjatë shekullit XIX filloi të zhvillohet e drejta botërore humanitare.

Vetë procesi i formimit të shteteve të reja, gjegjësisht hyrja e tyre në shoqëritë botërore, u kushtëzua nga respektimi i standardeve të caktuara në fushën e të drejtave të njeriut. Kështu, për shembull, Traktati i Berlinit i vitit 1878, fuqitë e mëdha të atëhershme - Mbretëria e Bashkuar, Austria,

2 MacFarlane and Khong, 2006, 23–61.

3 Tukididi, 1999.

4 Aristoteli, 1988.

Hungaria, Franca, Gjermania dhe Italia – e kanë njohur Serbinë, Rumaninë dhe Malin e Zi me kushtin që shtetet e sapo formuara të respektonin të drejtat e pakicave. Zhvillimi i ushtrive të përhershme dhe revolucioni industrial kanë bërë që luftërat të jenë disa herë më shumë me aktivitete shkatërruese se sa që ishin në periudhat e mëparshme. Shpërndarja e armëve bërthamore pas Luftës së Dytë Botërore dhe mundësia për shkatërrimin reciprok, politikës botërore i dha një vetë-shkatërrim të ri. Në përpjekjen për të rritur sigurinë e vet kombëtare, superfuqitë vënë në pikëpyetje mbijetesën e të gjithë njerëzimit.⁵ Tensionet shpërthyen gjatë krizës së raketave kubane në vitin 1962, kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik mezi iu shmangën konfliktit bërthamor dhe Luftës së Tretë Botërore. Më tej, në procesin e dekolonizimit u krijuan një numër i madh i shteteve të reja të cilat kanë qenë në pronësi të huaj (të jashtëm) apo kanë pasur sovranitet negativ, shtetet që kanë poseduar njohjen botërore dhe vend të vet në OKB. Këtyre shteteve shpesh u mungonte sovraniteti i brendshëm apo pozitiv, ose mundësia për të kryer autoritet efektiv në territoret e tyre, si dhe për të gjithë qytetarët e saj në mënyrë të barabartë të sigurojnë të mirat themelore publike dhe mbi të gjitha, të garantojnë sigurinë. Përfundimisht, Mary Kaldor shkruan: “Në fillim të shekullit XIX, marrëdhënia midis viktimave ushtarake dhe civile në luftëra ishte 8:1. Sot ky raport është pothuajse i kundërt tërësisht; në luftërat e viteve të nëntëdhjeta, raporti i viktimave ushtarake dhe civile ishte rreth 1: 8”.⁶

Edhe përkaj zhvillimit të idesë së të drejtave të njeriut, deri në fund të Luftës së Ftohtë, shqetësimi i sigurisë kryesisht ishte shteti dhe jo individët. Megjithatë, pas rënies së Bashkimit Sovjetik dhe fundi i tensioneve të mëdha ushtarake dhe ideologjike mes dy superfuqive dhe blloqeve të tyre, vjen deri në zgjerimin e nocionit të sigurisë. Ai shtrihet edhe në objekte të tjera të referimit, nga “poshtë: për grupet individuale dhe sociale, dhe nga “lartë” në rajon apo edhe në sistemin ndërkombëtar. Për këtë ulje të objektit të referimit në nivel të individit është veçanërisht e rëndësishme teoria kritike e sigurisë. Është analizuar përvoja e shekullit XX, shteti nuk përkufizohet si “pjesë e zgjidhjes” të sigurisë së individit, por si “pjesë e problemit” të sigurisë. Kjo është në kundërshtim jo vetëm me teorinë e shtetit Hobbesian, por edhe me të gjithë nocionet bashkëkohore të sigurisë.⁷

5 Ejuds F., *Megunarodna Bezbednost: Teorije*, Sektori i Nivoi, Beograd, 2012.

6 Kaldor, 2001, 22.

7 Booth, 1991.

1.1. Nocioni i sigurisë njerëzore

Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe tejkalimi nga struktura bipolare të marrëdhënieve botërore, kishte shumë shkencëtarë që janë marrë me problemet e zhvillimit, e sidomos në bashkësinë botërore që dëshiruan të përdorin “Dividendën e paqes”. Me fjalë tjera, ekzistonte vetëdije se tani kur tensionet globale janë zvogëluar apo janë zhdukur plotësisht, mjetet e investuara në mbrojtje duhet të drejtohen në zhvillimin ekonomik. Tashmë në Raportin e Zhvillimit Njerëzor në vitin 1993 nga ana e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) bënë thirrje për

(...) Nocioni i Sigurisë duhet të ndryshohet, në mënyrë që në vend të sigurisë kombëtare theks më i madh të vendoset në sigurinë njerëzore kështuqë, në vend të sigurisë që është arritur me theksimin e armatimit, duhet të ndryshohet me sigurinë që është arritur me zhvillimin njerëzor, prandaj, në vend të sigurisë territoriale theksi do të vendoset në sigurinë e shëndetit, ushqimit, punësimit dhe mjedisit jetësor.⁸

Përkufizimi i tillë i sigurisë njerëzore në këtë mënyrë përfshinë shtatë dimensione, edhe atë sigurinë ushqimore, shëndetin, ekologjinë, sigurinë personale, sociale dhe politike. Raportet e lartpërmendura nuk kanë lidhur sigurinë njerëzore vetëm për të mbrojtur individin kundër dhunës, por edhe për zhvillimin e tij të përgjithshëm.⁹ Ato kanë vënë bazat për kuptim më të gjerë të sigurisë njerëzore, i cili përfshin jo vetëm “lirinë nga frika”, por edhe “lirinë nga varfëria”, dhe në bazë të kësaj do të thotë liri nga të gjitha që mund të kërcënojnë mbijetesën e njeriut, jetën e përditshme dhe dinjitetin e individit.¹⁰

Kofi Annan, i cili ishte sekretari i përgjithshëm i OKB-së që nga viti 1997, kontribuoi ndjeshëm në zhvillimin e idesë së sigurisë njerëzore.¹¹ Ai madje konsideronte se mbrojtja e sigurisë njerëzore është mision i

8 UNDP, Human Development Report 1993, <http://hdr.undp.org/en/reports/global/hdr1993/chapters/> (10. april 2011).

9 Edhe pse raporti i vitit 1994 duhet të jap formë debatit në Samitin Botëror për Zhvillimin Social, i cili u mbajt në vitin 1995 në Kopenhagë, kjo nuk ndodhi. MacFarlane dhe Khong, viti 2006, 148

10 “Liria nga frika”, “lirinë e fesë” dhe “lirisë së fjalës”, janë liritë mbi të cilat presidenti amerikan Franklin Delano Roosevelt foli si objektivat e Shteteve të Bashkuara në botë në fjalimin e tij përurues më 6 janar në vitin 1941.

11 The Causes of Conflict and the Promotion of Durable Peace and Sustainable Development in Africa: Report of the Secretary General (13. april 1998), <http://www.un.org/ecosocdev/geninfo/afrec/sreport/main.htm> (10. april 2011).

rëndësishëm i OKB-së.¹² Shumë shpejt nocioni u pranua nga Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Sigurisë së OKB-së. Kriza e madhe financiare që goditi Azinë Lindore në vitin 1997 dhe 1998 shtoi interes plotësues të disa vendeve, para se gjithash Japonisë, për promovimin e versionit të tillë të gjerë të sigurisë njerëzore, që përveç mbrojtjes nga dhuna përfshinë edhe kërcënimin ekonomik për mirëqenien e individit. Rol të rëndësishëm kishte Kryeministri i Japonisë Keizo Obuchi, i cili në vitin 1998 sigurinë njerëzore e ka miratuar si pjesë e politikës së jashtme të Japonisë. Përveç kësaj, me iniciativën e tij dhe me përkrahje financiare nga Qeveria e Japonisë, është themeluar Fondi për Siguri Njerëzore (UNTFHS). Në të njëjtën mënyrë, me ndihmën e japonezëve në vitin 2001 është formuar Komisioni për Sigurinë Njerëzore. Raporti i tij me titull siguria njerëzore menjëherë në vitin 2003 është artikuluar si nocion i gjerë për sigurinë njerëzore.¹³ Në këtë raport, siguria njerëzore është përkufizuar si në vijim: Siguria njerëzore do të thotë mbrojtjen e lirive themelore - Liritë janë thelbi i jetës. Kjo do të thotë mbrojtja e njerëzve nga kërcënimet dhe situatat kritike (të rënda) dhe depërtuese siç është sot pandemia e virusit Kovid-19. Gjithashtu, kjo do të thotë përdorimi i proceseve të cilat janë bazuar forcat dhe preferencat njerëzore. Kjo gjithashtu do të thotë krijimin e sistemeve politike, shëndetësore, sociale, mjedisore, ekonomike, ushtarake dhe kulturore, që njerëzve u mundësojnë blloqe ndërtimi për mbijetesën, ekzistencën dhe dinjitetin.¹⁴

Nga ana tjetër, është zhvilluar ideja se nocioni i sigurisë njerëzore duhet të ngushtohet vetëm në “liria nga frika”. Nëse Japonia është shteti i cili më shumë është angazhuar për zgjerimin e sigurisë njerëzore, kurse shteti që në masë më të madhe ka promovuar ngushtimin e sigurisë njerëzore ishte Kanada.¹⁵ Së bashku me Norvegjinë, ajo udhëhoqi një rrjet për sigurinë

12 Megjithatë, edhe pse në periudhën e ardhshme Këshilli i Sigurimit ka miratuar një numër të rezolutave që janë bazuar në Kapitullin e shtatë të Kartës (“të paqes dhe të sigurisë botërore”) Nocioni siguri kombëtare, të drejtat e njeriut, dhe siguria njerëzore ende nuk është paraqitur në asnjë rezolutë.

13 Komisioni i themeluar nga Kofi Anan, ku ka pasur 10 personalitete të shquara nga e gjithë bota, bashkë-kryesohet nga Sadako Ogata dhe Amartya Sen. Një nga arsytet se pse Japonia ka iniciuar themelimin e komisionit, me një kuptim të tillë të gjerë të sigurisë njerëzore, është mospajtimi i tij me nocionin e ngushtë të sigurisë njerëzore, e cila është promovuar pas ad hoc Komisionin Ndërkombëtar për intervenimin dhe sovranitetin shtetëror. Në raportin e përgjegjësive së saj për Mbrojtjen në vitin 2002, Komisioni propozoi një ndërhyrjes humanitare, sa më shpejt që Japonia nuk u pajtua plotësisht.

14 Commission on Human Security, Human Security Now (New York, 2003), 4, <http://www.humansecurity-chs.org/finalreport/English/FinalReport.pdf> (10. april 2011).

15 Kanadaja ka këtë politikë të udhëhequr nga viti 1996, nga ana e Ministri i Punëve të

njerëzore, të formuar në vitin 1998 që të promovojë atë vizion të ngushtë për sigurinë njerëzore.

Në mesin e anëtarëve të tjerë në këtë rrjet janë Austria, Kili, Greqia, Irlanda, Jordania, Mali, Holanda, Sllovenia, Zvicra dhe Tajlanda. Ndër të tjerat, rrjeti për sigurinë njerëzore bazohet në Konventën universale të Otavës. Përveç kësaj, ky rrjet është përkushtuar në formimin e Gjykatës Penale Botërore në Hagë, luftën kundër HIV/SIDA, krimet të organizuar transnacional, pjesëmarrjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, etj. Lidhja e diskursit për të drejtat e njeriut me diskursin e sigurisë botërore më së miri mund të shihet duke krahasuar rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së të miratuar duke iu referuar nenit 7 të kësaj Karte (p.sh. Paqes Botërore dhe Sigurisë) gjatë Luftës së Ftohtë dhe pas saj. Me disa përjashtime (p.sh., Zimbabve, Namibia dhe regjimi i aparteidit në Afrikën e Jugut), Këshilli i Sigurimit të OKB-së në rezolutat në periudhën midis viteve 1945 dhe 1991 nuk mirrej me problemet e brendshme dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Megjithatë, pas përfundimit të luftës së ftohtë, kjo situatë ka ndryshuar rrënjësisht, sepse Këshilli i Sigurimit të OKB-së në sërë rezolutash, të cilat i referohen temave humanitare, të Nenit 7 (p.sh., Somalia, Bosnja, Ruanda, Haiti, Sierra Leone, Libi). Kështu, Neni 2.7 të kapitullit të parë të Kartës së OKB-së, në të cilin shteteve u është garantuar barazia e sovranitetit dhe respektimi i parimit të mosndërrhyrjes në punët e brendshme, është relativizuar në favor të të drejtave të bashkësisë ndërkombëtare, duke u mbështetur në kapitullin e shtatë të Kartës, situata e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut është interpretuar si kërcënim për paqen dhe sigurinë botërore. Me iniciativë të ish anëtarit të përhershëm, Kanada, Këshilli i Sigurimit në vitin 1999 ka filluar diskutim parimor në lidhje me marrëdhëniet në mes të mbrojtjes së civilëve, të paqes dhe sigurisë botërore. Kjo çoi në miratimin e Rezolutës 1296, në prill të vitit 2000, i cili është parimi i parë, dhe në mënyrë të qartë thekson se (...) sulmi i qëllimshëm ndaj popullatës civile ose personat e tjerë të mbrojtur, dhe shkeljet sistematike, të përhapura dhe flagrante të së drejtës ndërkombëtare humanitare, si dhe të drejtat e njeriut në kohën e konfliktit të armatosur mund të përbëjë kërcënim për paqen dhe sigurinë botërore dhe në këtë drejtim Kombet e Bashkuara riafirmojnë gatishmërinë e saj për të shqyrtuar situatën dhe kur është e nevojshme, të iniciojnë masat e duhura.¹⁶

Jashtme Lloyd Axworthy b(Lloyd Axworthy N.) gjithë politika e tij e jashtme është e bazuar në idenë e sigurisë njerëzore. Shih: DFAIT, 2002

16 Shiko: <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N00/399/03/PDF/N0039903.pdf?OpenElement> (11. prill 2011).

Në të njëjtin vit, me iniciativë të Kanadasë është formuar komisioni ad hoc ndërkombëtar për intervenim shtetëror dhe sovranitet, për të cilin raport thuhet se është përgjegjës për mbrojtjen e kuptimit të ngushtë të artikuluar të sigurisë njerëzore.¹⁷Në këtë dokument është

parashikuar se shtetet e fuqishme kanë detyrim të mbrojnë (R2P-detyrimi dhe përgjegjësia për mbrojtje) qytetarët e vet, nëqoftëse nuk mund ta bëjnë, humbin të drejta dhe përgjegjësi të caktuara sovraane, atëherë përgjegjësia bie në bashkësinë ndërkombëtare. Përgjegjësia e bashkësisë ndërkombëtare mund të jetë parandaluese (kur bëhet fjalë për parandalimin e katastrofës humanitare siç është sot pandemia e virusit Kovid-19), reaktive (kur duhet të reagojnë, nëse ajo ndodh) dhe rindërtuese (kur bëhet fjalë për ndërtimin e shoqërisë pas katastrofës humanitare). Koncepti i R2P (detyrimi dhe përgjegjësia për mbrojtje) - u miratua për herë të parë në Unionin Afrikan, përndryshe edhe në nivel të OKB-së Akti Final u miratua në Samitin Botëror në vitin 2005.¹⁸ Përfundimisht, OKB-ja është duke u përpjekur për të avancuar sigurinë njerëzore edhe në këtë fushë. Nocioni i sigurisë njerëzore është veçanërisht i rëndësishëm për procesin e ndërtimit të paqës dhe të shtet-ndërtimit për të gjitha shtetet anëtare në OKB.

Janë interesante dhe të rëndësishme edhe përpjekjet në nivel të BE-së, të miratojnë nocionin e sigurisë njerëzore, i cili do të jetë bazë e përbashkët e politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes (SPPM) në BE-së. Grupi i ekspertëve evropianë, të kryesuar nga Mary Kaldor, më 15 shtator të vitit 2004, dhe ish Përfaqësuesi i lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Javier Solana, prezantuan raportin me titull Siguria Njerëzore për Evropën: Doktrina për sigurinë njerëzore: Raporti i Barcelonës i grupit studimor për aftësitë e sigurisë së Evropës.¹⁹ Qëllimi i kësaj ishte të operacionalizojë Strategjinë evropiane për siguri, e cila ishte miratuar nga Këshilli i BE-së në vitin 2003.²⁰ Raporti në Barcelonë konkretisht thekson kuptimin e sigurisë njerëzore si “lirimi nga frika”. Në atë thuhet se “në kontekstin e ri global, politika e sigurisë e BE-së duhet të bazohet në sigurinë njerëzore, para sigurisë kombëtare. Siguria njerëzore paraqet lirinë individuale nga pasiguritë themelore”.²¹ Raporti

17 ICISS, Responsibility to Protect (Ottawa, december 2001), <http://www.iciss.ca/pdf/Commission-Report.pdf> (11. april 2011).

18 Rezoluta 1674 KS KB, <http://daccessddsny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N06/331/99/PDF/N0633199.pdf?OpenElement> (11. prill 2011).

19 Grupi i punës u ndoq nga 13 ekspertë të shquar.

20 BE, 2006.

21 A Human Security Doctrine for Europe: The Barcelona Report of the Study Group on Europe's Security Capabilities, 4, <www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_

numëron shtatë parimet e politikës së sigurisë njerëzore të BE-së që duhet të bazohen në: parimin e përparësisë së të drejtave të njeriut, parimi i ekzistencës së një mandati të qartë politik, parimi i multilateralizmit, parimi i qasjes prej poshtë-lart, parimi i fokusit rajonal, parimi i përdorimit të instrumenteve ligjore dhe parimi i përdorimit të forcës së duhur. Raportet e shkruara propozojnë krijimin e forcave civile-ushtarake për mbrojtjen e sigurisë njerëzore në nivel të BE-së, që do të numërojë deri në 15.000 njerëz dhe përdorimin e kapaciteteve ekzistuese në kuadër të politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes (PPSM-the common security and defence policy/politika e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes).²² Edhe pse BE-ja nuk ka pranuar zyrtarisht raportin e Barcelonës, ai vazhdon të jetë burim frymëzimi në temën se si duhet të duken fuqishëm vlerat e justifikuar (arsyetuara) të cilat janë të bazuara në politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes të BE-së.

1.2. Kritika e sigurisë njerëzore

Edhe pse nuk kishte konsensus për kuptimin e saktë, nocioni i sigurisë njerëzore shpejt fitoi një numër të madh të përkrahësve si në organizatat botërore të tilla si OKB-ja, mes “fuqive të mesme” të tilla si Kanadaja dhe Norvegjia, si dhe në kuadër të komunitetit akademik. Kanë filluar numër i madh i projekteve kërkimore në universitete dhe institute në mbarë botën, të cilat kanë mundësuar zhvillimin e një gjenerate të tërë të studiuesve të sigurisë njerëzore.²³ Megjithatë, nocioni i sigurisë njerëzore nuk është pranuar si komunitet i brendshëm universal shkencor. Në të kundërtën, kritikën më të forta për sigurinë njerëzore janë drejtuar nga qarqet shkencore, apo më saktësisht nga disiplinat akademike të studimeve të sigurisë. Këto kritika ishin të lidhura me nocionin dhe praktikën e sigurisë njerëzore.

Ndoshta kritika më e zakonshme dhe më e fuqishme e nocionit të sigurisë njerëzore ka lidhje me faktin se ky nocion është aq “tërësorë” apo i plotë. Kjo vlen veçanërisht për përkufizimin më të gjerë të sigurisë njerëzore,

[data/.../040915capbar.pdf](#)> (11. april 2011).

22 Nga viti 1998 deri në vitin 2010, kjo politikë u quajt Politika e Mbrojtjes dhe Siguria Evropiane (ESDP). Hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës më 1 dhjetor, 2010 nga ky vitëquhet politika e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes (CSDP).

23 Në rajonin e Ballkanit, gjithashtu, në fillim të viteve të mijëvjeçarit shtohet interesimi për konceptin e sigurisë njerëzore. Në Fakultet dhe institutet e Sigurisë janë themeluar Qendra për Hulumtime të sigurisë njerëzore, p.sh në Slloveni, Kroaci, Sërbi, Bugari, Shqipri dhe në Maqedoni.

pas të cilit nuk është vetëm “liria nga frika”, por edhe “liria nga varfëria”. Përfshinë përmbajtjen- duke filluar nga dhuna fizike, nëpërmjet mjedisit të shëndoshë e deri tek arsimit, nuk është më e qartë se çfarë është dhe çfarë nuk është fushë e sigurisë njerëzore. Në këtë mënyrë, humbet kufiri i qartë mes nocioneve të tilla siç është zhvillim i njeriut, të drejtat e njeriut dhe të sigurisë.²⁴ Përveç kësaj, në fushën e saj, nocioni i sigurisë njerëzore është shumë vështirë për t'u përdorur për zbulimin e lidhjeve shkakësore, të cilat kërkojnë që variablat e varura të janë të ndara qartë nga variablat e pavarura. Megjithatë, pa marrë parasysh sa vite ishin të arsyeshme thirrjet shkencore që nocioni i sigurisë njerëzore të ngushtohet dhe konkretizohet, megjithatë akoma nuk është arritur. Një nga arsyet për këtë është fakti se ithtarët kryesorë të këtij nocioni dëshirojnë që ky nocion të mbetet i hapur dhe gjithëpërfshirës. Sipas Roland Paris (profesor kanadez/siguria individuale), ideja për sigurinë njerëzore është (...) ngjitës që bashkon koalicion të përzier të “fuqive të mesme”, agjencive të zhvillimit dhe organizatave joqeveritare (OJQ-të), të cilat kërkojnë të devijohet vëmendja dhe burimet prej fushës së temave konvencionale të sigurisë të drejtohen drejt arritjes së qëllimeve që tradicionalisht bien nën rubrikën e zhvillimit ndërkombëtar.²⁵

Politika e bazuar në nocionin e sigurisë njerëzore ishte gjithashtu lëndë e kritikave të rënda. Për shkak të gjithëpërfshirjes të saj, politika për sigurinë njerëzore është kritikuar sepse nuk mund të vendosë prioritete të qarta. Siguria e ndonjë problemi të caktuar paraqet prioritet të tij, dhe vendosjen e problemit në krye të agjendës.²⁶ Është e vështirë të jetë e mundur, në qoftë se vendimmarrësit politikë udhëheqin logjikën e nocionit të sigurisë njerëzore, në të cilën çdo gjë është e rëndësishme për sigurinë e individëve, duke filluar nga minat anti-këmbësorike, pandemitë globale të viruseve (siç është sot pandemia e virusit Kovid-19) e deri në ngrohjen globale. Së dyti, duke injoruar rolin që shteti ka në arritjen e sigurisë së individëve dhe grupeve mund të jetë kundërproduktive, sepse shteti është i vetmi aktor që në fund të fundit, mund të garantojë këtë siguri.²⁷ Së treti, Sekuritarizmi i të drejtave të njeriut dhe zhvillimit njerëzor lehtë mund të çojë në militarizimin e këtyre problemeve. Këto aktorët tradicionalë të sigurisë sigurojnë vend të privilegjuar për të diktuar diskurset dhe praktikat në zonat ku më parë nuk kanë pasur kompetencë, të tilla si zhvillimi i njeriut dhe të drejtat e njeriut.²⁸

24 Paris, 2001.

25 Buzan, 2004, 369; Chandler, 2008.

26 Ejuds F., Megunarodna Bezbednost: Teorije, Sektor i Nivoi, Beograd, 2012.

27 Sørensen, 1996.

28 Qeveria e SHBA-së ka zhvilluar konceptin e provincave të Grupevetë Rindërtimit

Përveç kësaj, nocioni i sigurisë njerëzore është kritikuar edhe për shkak të legjitimitetit të ndërhyrjes humanitare, ose për shkak se ata inkurajojnë elitën e sigurisë së botës të zhvilluar të merren me të drejtat e njeriut në vendet e varfra dhe të pazhvilluara. Sipas kësaj kritike, politika për sigurinë njerëzore është, edhe pse ajo fillimisht kishte potencialin emancipues, sot u bë “besimi i drejtë i ri”, i cili vetëm përforcon strukturat ekzistuese politike dhe pabarazitë në mes veriut dhe jugut global.²⁹ Përfundimisht, realistët e rrënjosur nuk e pranojnë nocionin e sigurisë njerëzore, për shkak se ajo tërheq vëmendjen dhe resurset në interesat kombëtare dhe problemet strategjike, sesa në sfidat më pak të rëndësishme humanitare. Por sfidat humanitare dhe shëndetësore në shekullin XXI realizohen me lloje të rejtatë luftës e cila quhet “lufta hibride” ku armikun e njohim por nuk e shohim me përdorimin e bioterrorizmit duke përhapur viruse vdekjeprurëse (siç është sot pandemia e virusit Kovid-19). Luftë kjo që është dedikuar kundër sigurisë njerëzore gjegjësisht kundër individit në mbarë botën për interesat gjeopolitike të fuqive të mëdha.

2. Kërcënimet hibride – Luftimi hibrid – Luftën ku armikun e njohim por nuk e shohim

2.1. Hyrje³⁰

Sipas natyrës kërcënimet hibride nuk janë të reja. Në fakt i ri është perceptimi të cilin e përcaktojnë këto kërcënime multimodale, për të cilët është e nevojshme qasja e kombinuar gjithëpërfshirëse nga masat konvencionale dhe jo-konvencionale të agjencive shtetërore dhe të sigurisë. Përgjigja në ballafaqimin me këto kërcënime duhet të jetë proporcionale, me spektër të gjerë, nga vetëmbrojtja civile dhe masat policore, deri në luftën kundër rrebelimit dhe ndërmarrjen e masave ushtarake.³¹ Diversiteti dhe kompleksiteti

(Ekipet e Rindërtimit Krahinor Ing.) Të përbërë nga personeli ushtarak, diplomatë dhe ekspertë të zhvillimit dhe qeverisjes së mirë, dhe të cilat kanë për detyrë nën komandën e ushtrisë amerikane të ndihmojnë rindërtimin postkonfliktual dhe shtet-ndërtimit. Këto ekipe kanë qenë deri tani të angazhuar në Afganistan dhe Irak.

29 Ryerson, 2010.

30 Prof.Dr.Muhamet Racaj, Luftë ku armikun e njohim por nuk e shohim-Lufta hibride, Bota sot, 16.04.2020

31 Bachmann, S.-D. & Gunneriusson, H. „Hybrid wars: the 21st-century’s new threats to global peace and security“, *Scientia Militaria, South African Journal of Military Studies*, Vol. 43, No. 1, 2015

i kërcënimeve shkakton frikë në shoqëritë, sepse është e vështirë të zbulohet dhe kuptohet. Çfarë paraqet kërcënim i hibrid? I nevojshëm është përkufizimi i cili nuk do të lëshojë karakteristikat e rëndësishme të kërcënimeve të ardhshme, por në të njëjtën kohë të mos shkaktojë konfuzion në konceptet e definimit të kërcënimeve. Kërcënimet hibride paraqesin rrjet të organizuar të njerëzve me kapacitete informatike dhe ushtarako-teknike. Këto rrjete kanë aftësi të zhvillojnë luftë kundër ushtrive të shteteve bashkëkohore, sepse fusha e veprimit të tyre mbulon spektrin e gjerë të konfliktit, duke lëvizur në mënyrë të paqartë në vijë të ngushtë mes rebelëve, terrorizmit dhe luftës.³² Kërcënimet hibride në radhët e tyre përfshijnë kriminelë dhe grupe kriminale që punojnë në mbështetje të forcave të rregullta dhe të parregullta ushtarake. Si shembull mund të përmendet konflikti Ruso-gjeorgjian në vitin 2008, në të cilën Rusia angazhoi elemente kriminale në Osetinë Jugore që kryejnë spastrime etnike në rajon.³³ Kërcënimet hibride janë të aftë të adaptohen dhe të kalojnë nga një formë në formën tjetër. Shpejtësia e tyre, shkathhtësia, larmia dhe ndryshueshmëria janë kryesore për suksesin e tyre në luftën kundër kundërshtarit shumë më të madh. Kërcënimet hibride adaptohen në dy mënyra: natyrore dhe të kontrolluara (drejtuara).

Adaptimi natyror paraqitet si aktor shtetëror dhe jo-shtetëror, që zotëron ose përshtat aftësitë e tij që të ushtrijë fuqi politike, ekonomike, ushtarake dhe informative. Adaptimi natyror mund të zhvillohet përmes:

- Pajisjes me teknologji bashkëkohore, kapacitetet ose resurset (financiare dhe materiale) kryesore.
- Organizimit efikas.
- Përdorimit efikas të informacioneve nga mjedisi, formimi i aleancave rajonale ose globale.

Adaptimi i kontrolluar bazohet në mësimet shkencore, ndërsa ka të bëjë me kundërshtimin e fuqisë dhe ndikimin e aleatëve perëndimor. Kërcënimet hibride do të kontrollojnë dhe drejtojnë aftësitë dhe kapacitetet e tyre në përputhje me aksionet që do të ndërmarrin aleatët perëndimor. Ato do të jenë gjithçka që aleatët perëndimor nuk janë. Të suksesshme do të jenë ato që zotërojnë aftësitë e nevojshme për veprim, reagim dhe adaptim të shpejtë dhe kreativ. Kërcënimet hibride shpejtë mësojnë dhe ndryshohen, pa

32 Gary H. Cheek, "Effects-Based Operations: The End of Dominant Maneuver," in Transformation Concepts for National Security in the 21st Century, Carlisle Barracks, PA: Strategic Studies Institute, U.S. Army War College, September 2002

33 Jane Buchanan, „Up in Flames: Humanitarian Law Violations and Civilian Victims in the Conflict Over South Ossetia“, Human Rights Watch (Organization), Human Rights Watch, 2009

kufizime, pa rregulla dhe burokraci, duke u adaptuar duke përdorur të gjitha burimet e disponueshme të fuqisë që i kanë në dispozicion.

Sipas disa hulumtimeve, termi për herë të parë në publik përmendet në punimin e Marinasve amerikan të botuar në vitin 1998, në të cilën aftësia për kryerjen e detyrave ekspedituese përshkruhet si “forcë hibride për luftë hibride” dhe “luftimi e cila gjendet në udhëkryqin mes luftimit special dhe konvencional” me qëllim të përshkruhet kombinimi i forcave konvencionale dhe jo-konvencionale si mënyrë më efektive të përdorimit të resurseve ushtarake të kufizuara. Më vonë, në vitin 2002 termi përdoret gjatë studimit të lëvizjes separatiste çeçene dhe analizën e mjeteve për menaxhimin me veprimet e dhunshme, të “shoqërive të përziera dhe hibride”. Veçanërisht është theksuar se luftimi hibrid do të bëhet dominues duke pasur parasysh se përdorë taktikë guerile dhe ushtritë moderne që janë të zhvilluara shumë në mënyrë burokratike dhe teknologjike që do të ballafaqohen me shumë sfida. Që të identifikohen dhe shfrytëzohen pikat e dobëta të armikut hibrid të nevojshme janë doktrina të reja dhe procedura operative të përshtatura. Kundërshtarët inferioritetin e tyre në kapacitet dhe aftësitë do të kompensojnë me përdorimin e veprimeve terroriste dhe rrebele dhe taktika guerile. Veprimet do të kryejnë formacionet paraushtarake dhe grupet e organizuara kriminale përmes sulmeve kibernetike mbi rrjetet politike, financiare dhe të komunikimit.

2.2. Përkufizimi i luftës hibride

Në hulumtimin për “paraqitjen e luftërave hibride” në vitin 2007, paraqitet përkufizimi vijues: “grup i formave të ndryshme të luftimit duke përfshirë edhe aftësi konvencionale, taktika dhe formacione të parregullta, akte terroriste të dhunës dhe frikësimit dhe trazira kriminale”.³⁴ Përveç elementeve të lartëpërmendur, forcat perëndimore vendosin se nuk ka nevojë nga përkufizimi zyrtar i termit luftim hibrid dhe rekomandojnë të mos futet nën-terminologji e re të luftimit. Ky qëndrim menjëherë ndryshohet në vitin 2014 kur Rusia e aneksoi Krimenë dhe aktivitetet përshkruhen si diçka e re.

Nga ana tjetër, Rusia për herë të parë përdori termin “luftim hibrid” në vitin 2016, të prezantuar nga Kryeshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral Valerij Gerasimov. Ai luftimin hibrid e karakterizon si luftim modern dhe

34 Thomas Huber, “Compound Warfare: A Conceptual Framework,” in *Compound Warfare: That Fatal Knot*, ed. Thomas M. Huber (Fort Leavenworth, KS: U.S. Army Command and General Staff College Press, 2002) 1-317

përfshinë “revolucionet e larme” që kanë për qëllim të marrin vijat mes luftës dhe paqes. Gerasimov thekson se mjetet jo-ushtarake për realizimin e objektivave ushtarake dhe strategjike janë të shumta dhe në shumë raste kanë tejkaluar fuqinë e armatimit dhe efektivitetin e tij. Në vitet e kaluara ka pasur shumë propozime për mënyrën në të cilën duhet të kundërvihet dhe luftojë kundër aktorëve jo-shtetëror dhe aktorët shtetëror të cilët duken si forca hibride. Pyetja më e rëndësishme në të cilën duhet të përgjigjemi është a përdoret në luftë e njëjta strategji ose taktikë të cilën e përdorë kundërshtari ose të bëhet diçka ndryshe ose e papritur. Ka studiues që rekomandojnë adaptimin, zbatimin e taktikave të reja dhe mbindërtimin e procedurave por rrallë kush rekomandon specifika për atë si në fakt të ballafaqohet me kërcënimet e reja hibride (siq është virusi Kovid-19). Sipas disa drejtuesve të lartë të sistemeve kolektive të sigurisë, qëllimi kryesor është krijimin e ndikimit që është fuqishëm e mjaftueshme por nën pikën kritike për aktivizimin e nenit 5, dhe kështu të arrijë të realizohen objektivat e dëshiruara pa provokimin e kundërshtarit ose armikut të aktivizojë reagimin mbrojtës. Termi operacione hibride ndoshta është më e saktë për kuptimin e karakterit të taktikave që përdoren gjatë luftës së pashpallur që në kontekst të NATO-s janë skenarë para aktivizimit të nenit 5. Pavarësisht se si është përkufizuar luftimi hibrid, sfida më e madhe është gjetja e mënyrës për ballafaqimin me oponentin i cili i përdorë të gjitha mjetet e nevojshme, konvencionale dhe jo-konvencionale, legale dhe ilegale, të rregullta dhe të parregullta, që të dobësojë objektivin para se të shpallet lufta.

Në vitin 2013, është prezantuar modeli që përshkruan synimet ruse dhe saktëson cilat masa do të ndërmerren për realizimin e interesave kombëtare. Ky model është i njohur si “Strategjia e Gerasimovit”. Ai thekson se në botë roli i mjeteve jo-ushtarake për realizimin e objektivave politike dhe strategjike është forcuar deri në atë shkallë që në shumë raste ato tejkalojnë fuqinë dhe efektivitetin e armës. Mjetet jo-ushtarake i përfshijnë sektorët politik, ekonomik, shëndetësor, informatikë dhe tjera në kombinim me potencialin e protestave popullore. Sipas Gerasimov, përdorimi i forcave për operacionet speciale dhe forcat tjera ushtarake mund të jetë e nevojshme, por këto forca duhet të përdoren të fshehura nën aktivitete tjera që të fshihet përdorimi i vërtetë i subversionit, frikësimit dhe taktikat klasike jo-konvencionale. Në fazën fillestare të mobilizimit hibrid përqendrimi është dhënë në metodat jo-ushtarake dhe theksohet popullata civile dhe faktori njerëzorë. Formimi i koalicioneve, shoqatave dhe grupet opozitare politike dhe zbatimin e presionit politik, ekonomik dhe diplomatik janë mjete që mund të shfrytëzohen si instrumente

të fuqisë për ndikimin mbi popullatën civile. Në doktrinën zyrtare të miratuar theksohet se konfliktet moderne kërkojnë përdorimin e aksioneve indirekte dhe asimetrike duke përfshirë edhe masat jo-ushtarake me përdorimin masiv të protestave dhe financimin e jashtëm të forcave politike dhe lëvizjet shoqërore.

Ekziston edhe një term popullor që ka të bëjë me luftimin hibrid, zonë gri, shpesh e përshkruar si hapësirë konceptuale midis luftës dhe paqes. Që të përshkruhen konfliktet në zonën gri përdoren edhe terme tjera siç janë: lufta të vogla, konflikte me intensitet të ulët dhe operacione ushtarake jashtë luftës. Mirëpo nëse dëshirojmë zona gri të kontribuojë në kuptimin e konfliktit para se të shpallet lufta, forcat për operacionet speciale do të jenë më mirë të përdorura përderisa kjo nuk vëzhgohet si strategji por si gjendje natyrore ose pandemi virusale. Luftimi i parregullt është strategjia ushtarake për arritjen e rezultateve më të mira në fazën konceptuale mes diplomacisë dhe luftës.

Një nga aspektet më të rrezikshme të kërcënimeve hibride është aftësia për transformimin në forma të ndryshme. Nëqoftëse bëhet fjalë për grup militant të organizuar si forcë ushtarake, lehtë mund të zhvesh uniformën dhe shenjat për statusin e tij dhe të përshtatet në popullatën lokale. Forcat rrebele thjesht vetëm do të lënë armët dhe do të shkrihen në popullatën e pafajshme. Kriminelët mund të paraqiten si polic që të arrijnë qasje deri në objektet strategjike. Kërcënimet hibride shfrytëzojnë dobësitë e identifikimit pozitiv.³⁵ Mjedisi i sigurisë ndërkombëtare është mbushur me aktorë që zbatojnë aktivitete kundër interesave të Aleatëve perëndimor, por të njëjtat janë pa vizualizim të qartë për statusin e tyre të kërcënimit, gjegjësisht shpesh këto kërcënime hibride janë identifikuar gabimisht si aktorë miqësorë ose neutrale.

Koncepti i luftërave “konvencionale” dhe “jo-konvencionale” dhe metodat “tradicionale” kundrejt “adaptimit”, janë arma e kërcënimit hibrid.

Konceptet e përkohshme të luftërave “konvencionale” dhe “jo-konvencionale” dhe metodat “tradicionale” kundrejt metodave “adaptuese” janë armë për kërcënimin hibrid. Këto koncepte kërcënimet hibride i shikojnë në mënyrë holistike dhe nuk përpiqen ta ndajnë në pjesë. Forcat e kërcënimeve hibride në moment të caktuar që të arrijnë në qëllimet e tyre, do të jenë në rol të njëjësive ushtarake të rregullta. Në situatë tjetër do të veprojnë si forca ushtarake të parregullta, ndërsa shpesh edhe të kombinuara. Kërcënimet hibride do të veprojnë në shumë mënyra, mirëpo gjithmonë do të mbajnë aftësinë të adaptohen në kohën dhe vendin në të cilin operojnë.

35 Dëshmi që tregon se ju jeni ato që thoni se jeni, gjegjësisht dëshmi për vërtetimin se jeni mes grupit të njerëzve që tashmë janë të njohur për sistemin, ndërsa njohja nga sistemi çon drejt pranimit.

Përmes strukturës formale dhe marrëveshjes jo-formale, forcat paraushtarake dhe ushtarake shtetërore mund të punojnë në marrëveshje të niveleve të ndryshme me grupet rrebele, guerile dhe kriminale për realizimin e qëllimeve të përbashkëta. Zakonisht, qëllimi i përbashkët është heqja e aleatëve perëndimor nga fusha e tyre e veprimit. Qëllimet e kërcënimeve hibride mundet por jo edhe patjetër të përkojnë me ato të aktorëve tjerë shtetëror dhe jo-shtetëror që veprojnë në zonë të njëjtë gjeografike.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të aktorëve dhe pjesëmarrësve në mjedisin e sotëm kompleks global të sigurisë. Më dominuese janë shtetet kombëtare apo aktorët shtetëror, megjithatë në raste të caktuara pushteti është në duart e aktorëve jo-shtetëror ose jo-traditional. Për përkufizimin e aktorëve në mjedisin operacional të kërcënimeve hibride e nevojshme është vlerësimi dhe analiza e vazhdueshme, përmes të cilës do të konfirmohen motivet, qëllimet, aftësitë dhe kufizimet e kërcënimit hibrid. Kjo ka të bëjë me kategoritë e kërcënimeve që mund të kombinohen, të plotësohen ose lidhen njëra me tjetrën me qëllim të rrisin kërcënimin dhe aftësitë hibride. Komponentët kryesor të kërcënimeve hibride janë dy ose më shumë, si më poshtë:

- Forca ushtarake.
- Forca jo-ushtarake e shtetit kombëtar (forcat për sigurinë e brendshme, policia ose sigurimi kufitar).
- Grupet rrebele dhe terroriste (lëvizje që kryesisht mbështeten në përmbysje dhe dhunë).
- Njësitë guerile (forca autoktone të parregullta që operojnë në territor të okupuar).
- Organizata kriminale (banda, kartelat e drogës ose hakerët).

3. Bioterrorizmi si metod dhe formë e luftës hibride

3.1. Hyrje

Sipas Qendrës për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve në SHBA, bioterrorizmi përkufizohet si “lirimi i qëllimshëm i virusit, baktereve ose kërpudhave të cilët mund të infektojnë ose të vrasin njerëz, bagëti ose agrikulturë”.

Terroristët përdorin agens biologjik, sepse ato shpesh janë të vështira për zbulim, ndërsa fillimi i sëmundjes mund të vonohet nga disa orë deri në disa ditë, duke rritur efektin e përhapjes. Agensët për bioterrorizëm janë zgjidhje e

thjeshtë për terroristët, sepse ato janë të lehta dhe të lira për prodhim, të lehta për distribuim dhe mund të shkaktojnë efekte masive.³⁶

3.2. Historia e përdorimit të armëve biologjike

Historia e përdorimit të armëve biologjike është e gjatë, ndërsa shembulli më i vjetër na kthen pas në kohën më shumë se 2500 vjet: Asirianët – Perandoria Asiriane e cila është gjendur në qytetin Ashur në lumin Tigar, në hapësirën e Mesopotamisë (Iraku i sotëm) e infektuan pusin e armikut të tyre me kërpudha, të cilat kishin përmbajtje kimike, ndërsa konsumi i ujit të prishur ka çuar deri në halucinacione, në disa raste edhe vdekje. Në vitin 1300, luftëtarët mongol i rrethuan Tatarët në qytetin e Krimesë, Kafa. Gjatë rrethimit, shumë tatarë kanë vdekur nga murtaja, ndërsa trupat e tyre të pajetë të infektuar janë hedhur nëpër muret e qytetit.³⁷ Disa ekspertë pohojnë se kjo taktikë ndoshta është përgjegjëse për përhapjen e murtajës – vdekja e zezë në Evropë. Nëse është kështu, ky përdorim i hershëm i armës biologjike ka shkaktuar vdekje të rreth 25 milion evropianëve. Kjo është shembull i rëndësishëm për fushëveprimin potencial të luftës biologjike, për paparashikueshmërinë e saj dhe thjeshtësinë e frikshme. Në vitin 1763, ushtria britanike është përpjekur të përdorë fruthin si armë kundër amerikanëve vendas në rrethimin e Fort Pit. Britanikët kanë dhuruar batanije nga spitali që i kanë përdorur të sëmurët nga fruthi, me qëllim të përhapin sëmundjen tek popullata lokale.

3.3. Sa është i mundshëm sulmi nga bioterrorizmi sot?

Përdorimi i këtij lloji të armëve ka avantazhe të caktuara për terroristët. Kjo ka potencial të shkaktojë dëm të madh, është shumë e lirë për prodhim, në krahasim me sistemet raketore bashkëkohore dhe projektileve ose pajisjeve tjera të teknologjisë së lartë. Gjithashtu, arma biologjike mund të “aktivizohet” edhe pas një periudhe të gjatë kohore, ndërsa autori ka kohë të ikë pa u zbuluar. Arma biologjike vështirë se mund të kontrollohet ose të parashikohet në situata të caktuara në fushë betejë, sepse ekziston rrezik i

36 Д-р Ненад Танески; Биотероризам; Штит бр.129 fq. 24-27, април, 2020

37 Derbes VJ. „de Mussis and the great plague of 1348“, JAMA, 1966

rëndësishëm se trupat e të dy palëve ndërluftuese do të preken.³⁸ Megjithatë, në rastin me bioterrorizmin, situata më e favorshme është se autori mund të sulmojë objektiv të largët si terrorist individual i vetëm, me rrezik shumë të vogël për atë. Zakonisht gjenden në natyrë, por mund të modifikohen në laborator që të rritet rezistenca e tyre ndaj antibiotikëve dhe mundësia për përhapjen në mjedisin. Agensët biologjik dhe kimik mund të përhapen përmes ajrit, ushqimit ose ujit. Terroristët përdorin agensë biologjik, sepse ata janë të vështirë për zbulim, ndërsa fillimi i sëmundjes mund të vonohet nga disa orë deri në disa ditë, duke rritur efektin e përhapjes. Agensët për bioterrorizëm janë zgjidhje e thjeshtë për terroristët, sepse ato janë të lehta dhe të lira për prodhim, të lehta për distribuim dhe mund të shkaktojnë efekte masive.

Megjithatë, problemi është në atë që me bioarmët lehtë mund të ndikojnë edhe ndaj forcave armiqësore. Terroristët kërkojnë armë biologjike si metodë për krijimin e panikës masive. Jemi të vetëdijshëm se shkaktimi i qëllimshëm i viktimave civile konsiderohet e palejuar. Për fat të keq, agensët që i përdorin bioterroristët vështirë kontrollohen dhe ndikojnë mbi civilët. Në 100 vitet e fundit, SHBA dhe bashkësia ndërkombëtare përjetuan më shumë akte të bioterrorizmit që ishin drejtuar drejt civilëve. Në Luftën e parë botërore Gjermania zbatoi fushatë biologjike me “sabotim” në Francë, Rumani, Rusi dhe SHBA, me infektimin e kuajve me sëmundje të virusit.³⁹

Në vitin 1972, në SHBA janë arrestuar dy student sepse kanë planifikuar të helmojnë ujin që furnizon Çikagon me baktere tifoide. Në vitin 1984, lëvizja Rainesch në Oregon, SHBA, u përpoq të ndikojë në zgjedhjet lokale me infektimin e dorezave të dyerve të restoranteve dhe bareve me bakterin “salmonella”. Në vitin 1995, organizata terroriste religjioze “Aum Shinriko” liroi gazin sarin në metronë në Tokio, duke vrarë 11 njerëz, ndërsa duke lënduar disa qindra.⁴⁰ Udhëheqësi i tyre, Shoko Asahara, ishte ekzekutuar për vrasje masive. Në vitin 2009 deri në zyrat për mediumet dhe Kongresin amerikan në pesë konverta ishte dorëzuar “antrax”. Grupet terroriste gjatë kohë inkurajohen dhe tregojnë prirje të veçantë për zbatimin e sulmeve biologjike, agrokulturore ose kimike. Mbështetësit e SHI-së shfrytëzuan krizën me kontaminimin e dredhëzave në Australi në vitin 2018, dhe shkaktuan frikë dhe panik, duke detyruar demokracitë perëndimore të bëjnë

38 Lisa Idzikowski, „Chemical and Biological Warfare“, Greenhaven Publishing LLC, 2019

39 Vassil St. Georgiev,, National Institute of Allergy and Infectious Diseases, NIH: Volume 2: Impact on Global Health“, Springer Science & Business Media, 2009

40 Ian Reader, „A POISONOUS COCKTAIL? Aum Shinrikyô’s Path to Violence“, NIAS – Nordic Institute of Asian Studies, NIAS Press, 2011

kontroll të detajuar të ushqimit të freskët e cila distribuohet për njerëzit. “Al Fakir”, një nga mediumet për mbështetje të SHI-së, në korrik të vitit 2018 publikoi video në të cilën bisedohet si të kryhet biosulm në Perëndim, sulm i cili nuk mund të zbulohet ose të ndiqet nga autoritetet. Ato dhanë udhëzime si me ujë të helmuar me virus dhe bakterje të kontaminohen artikujt e freskët. Organizata terroriste Shteti islamik (SHI), publikisht mbështeti shfaqjen e koronavirusit dhe vdekshmërinë e tij. SHI përshëndet përhapjen vdekjeprurëse “Koronavirusin” me raportimin përmes buletinëve zyrtar të tyre në internet dhe grupin mediatik të tyre për mbështetje. Grupi terrorist pohon se edhe fatkeqësitë natyrore paraprake që morën shumë jetë njerëzore, është dëshmi se Zoti i tyre u ndihmon në eliminimin e kundërshtarëve të tyre. Kjo është përpjekje SHI të impresionojë dhe motivojë ndjekësit e tyre, se nëse fatkeqësia natyrore shkakton aq shumë vuajtje, xhihadistët mund të shkaktojnë destruktiv me zbatimin e metodave artificiale.⁴¹

Sëmundjet e shaktuara nga armët biologjike mund të grupohen në tri kategori. Klasifikimi bazohet në mundësinë e përhapjes, sëmundshmërisë dhe mortalitetit, potencial i shkaktimit të panikës dhe nivelin e kërkesës nga sistemi shëndetësorë.

Kategoria A: Sëmundje me prioritet më të madh që shkakton rrezik për sigurinë kombëtare, lehtë transferohet, kanë sëmundshmëri dhe mortalitet të lartë, do të ketë ndikim të madh për shëndetin e njerëzve dhe do të shkaktojnë panik, dhe kërkojnë gatishmëri të veçantë të sistemit shëndetësorë.

Kategoria B: Viktima. Ky ndikim është i barabartë, ndërsa mund të tejkalojë rastin e sulmit me armë bërthamore. Sëmundje me prioritet të lartë që kanë potencial të shkaktojnë sëmundje dhe mortalitet të konsiderueshëm, me shfaqjen e patogjeneve që mund të përhapen në mënyrë masive.

Kategoria C: Sëmundje prioritare të matshme me sëmundje dhe mortalitet të vogël që më vështirë përhapen. Sulmi biologjik efektiv mund të jetë shkatërrues, duke shaktuar miliona viktima.

Sipas analizave të ekspertëve të SHBA-së, lirimi prej 100 kilogram “antrax” mbi Uashingtonin, mund të shkaktojë midis 130.000 dhe 3.000.000 raste vdekje nga thithja e agensit. Sepse simptomat e hershme janë të ngjashme me gripin, diagnoza e vërtetë mund të njihet vetëm kur infektimi do të përhapet, me vdekshmëri prej 90%.⁴²

41 Bridget Johnson, „ISIS Lauds ‘Death and Terror’ of Coronavirus Outbreak“, Homeland Security Today, January 27, 2020

42 Johns Hopkins University - Center for Civilian Biodefense Studies, „Anthrax“, Johns Hopkins Public Health Magazine, 2001

Numri i madh i pacientëve mund ti shterin rezervat e disponueshme për antibiotikët efektiv. Ndikimi potencial i kësaj arme biologjike dhe të ngjashme e cila mund të gjendet në duart e terroristëve, hap pyetjen për parandalimin paraprak dhe mënyra të dizajnuara për ballafaqimin me ngjarje të tilla.

Të njohura janë rastet kur grupet terroriste kërcënohen dhe paralajmërojnë sulm biologjik, që të sigurojnë publicitet dhe të shkaktojnë panik.⁴³ Shërbimet inteligjente të cilët bëjnë mbikëqyrje mbi grupet terroriste dhe individët, do të konfirmojnë ose hedhin kërcënimin. Shërbime të caktuara dhe organizata ushtarake posedojnë detektorë për zbulimin e agensëve biologjik. Ndoshta do të jetë e nevojshme materiale të dyshuara të caktuara të transportohen në laboratore të specializuara, ndërsa e gjithë kjo është në dëm të kohës së nevojshme për reagim dhe parandalim.

Institucionet shëndetësore duhet të jenë të aftësuar të reagojnë ndaj sulmeve biologjike. Situata mund të lëviz nga ngjarje në të cilën janë të përfshira pak pacientë deri në ballafaqimin me qindra persona që ndoshta kanë qenë të ekspozuar nga agensi. Për fat të keq, momentalisht, duket se nuk ekziston qeveri e cila ka siguruar institucione që janë plotësisht të trajnuara në mënyrë të veçantë dhe pajisur të reagojnë në situatat e bioterrorizmit.

Me rëndësi thelbësore është nëpunësit shëndetësorë të strukturojnë metoda efektive për ballafaqimin me pasojat nga sulmi. Në analizat dhe vlerësimet për sulmet bioterroriste, në skenarët më të vështirë zakonisht arrihet në konkludim se “do të mund të ketë aq shumë viktima që më shumë nuk do të mund të bëhet asgjë”.

Megjithatë, plani për reagim nga kërcënimi duhet të jenë mjaftueshëm fleksibil që të mundet vazhdimisht të plotësohen kërkesat të cilët janë fluide. Përvojat me katastrofa reale dhe të simuluar, dëshmojnë se grupet mjekësore që paraprakisht kanë zhvilluar dhe kanë praktikuar plane të duhura, arrijnë reagim efektiv dhe koordinativ në situata me viktima masive. Kundrejt kësaj, reagimet e paplanifikuara në kohë rezultojnë me reagim të paorganizuar, joefikas, që dëmton të sëmurët ose personat e lënduar, dhe madje edhe mund të kontribuojnë edhe për viktima shtesë.⁴⁴

Dy skenare të ndryshme duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të reagimit ndaj bioterrorizmit. Së pari, pas sulmit biologjik të kryer në mënyrë sekrete, rezultati fillestarë do të jetë shfaqja e pacientëve të shqetësuar, në

43 Mollie Williams; Lisa Armstrong; Daniel C. Sizemore., „Biologic, Chemical, and Radiation Terrorism Review“, StatPearls Publishing LLC,2020

44 Danzing R., „Catastrophic Bioterrorism: What Can Be Done?“ Washington, D.C.: Center for Technology and National Security Policy, 1998

nivel lokal ose në lokacione të ndryshme në gjithë botën. Situata do të bëhet seriozisht e qartë, sepse më shumë persona do të kërkojnë ndihmë mjekësore. Kjo gjendje mundet shpejtë të zhvillohet në situatë me viktima masive. Megjithatë, nëse njihet në kohë, do të kursehet kohë që të organizohen resurset për mbrojtje shëndetësore në bashkësinë dhe të zbatohet plani për reagim ndaj bioterrorizmit.

Në skenarin e dytë, me sulm bioterrorist të paralajmëruar, numër i madh i personave do të kërkojnë ndihmë mjekësore dhe trajtim urgjent për kohë të shkurtër. Përgjegjësia e institucioneve mund të prolongohet deri sa studimet laboratorike nuk vërtetojnë se a ka ndodhur sulm i vërtetë. Çdo prolongim mund të rezultojë në çrregullimin serioz të shëndetit të viktimave, ndërsa edhe me pasoja tjera në ngjarje reale. Përveç vlerësimit dhe trajtimit të lënduarve, do të jetë e nevojshme edhe dokumentimi. Vendimi a duhet dhe çfarë duhet të dekontaminohet, duhet të bëhet në bashkëpunim me organizatat shëndetësore përkatëse lokale, shtetërore ose ndërkombëtare. Përvojat e deritanishme me viktima masive reale dhe të stimuluar dhe situata në katastrofa treguan rëndësinë kryesore të komandimit, kontrollit, komunikimeve dhe koordinimit të ngjarjeve të tilla.

Një nga pyetjet më të dhimbshme në skenarët me sulmet bioterroriste është “kush është kompetent”. Problemet që rrjedhin nga pasiguria për atë kush është kompetent, u tregua si pengesë e madhe për ballafaqimin efikas me kërcënimin, ndërsa dëmi shkakor nga menaxhimi i keq, për fat të keq më shumë e ndjejnë personat e cenuar.⁴⁵

Analizat nga katastrofat në të kaluarën vazhdimisht na kujton problemet e mbajtjes së komunikimeve efektive. Problemet variojnë nga pajisja jokompatible deri në përdorimin joadekuat e cila i parandalon transmetimet urgjente të informacioneve. Mbështetja në telefonat celularë si alternativë nuk është reagimi i sulmit terrorist masiv. Numrat e telefonit dhe web-faqet e internetit të shënuara për ndihmë duhet të jenë të disponueshme në çdo kohë.

Për fat të keq, hulumtimet prej kohësh zbulojnë se institucionet shëndetësore në shumë shtete nuk kanë qasje në internet, nuk përdorin postë elektronike dhe nuk kanë përvojë për shfrytëzimin e shërbimeve online dhe mbështetjen nga institucionet tjera shtetërore. Theksi duhet të vendoset në raportimin në kohë reale për ngjarjet e pazakonta, nëse të dhënat janë të dobishme për paralajmërimin e hershëm dhe njohjen e sulmit biologjik.

45 David J. Dausey, Nicole Lurie, Alexis Diamond, Barbara Meade, Roger Molander, Karen Ricci, Michael Stoto, Jeffrey Wasserman „Bioterrorism Preparedness Training and Assessment Exercises for Local Public Health Agencies“, RAND Corporation, 2005

Fakt është se sistemet e shëndetit publik në disa shtete nuk janë të përgatitur në reagimin adekuat, për shkak të mungesës të koordinimit mes institucioneve shëndetësore, drejtorive për menaxhimin me kriza dhe shërbimeve për zbatimin e ligjit. Për shkak të numrit të madh të institucioneve të cilat do të kyçen në reagimin e sulmit bioterrorist, mungesa e koordinimit mund të bëhet pengesë kryesore për reagim optimal. Koordinimi i duhur do të ndihmojë jo vetëm për reagimin më efektiv, por edhe për marrjen e mbështetjes dhe ndihmës nga institucionet tjera.

Koordinimi i duhur do të ndihmojë të krijohen dhe të lehtësohen zgjidhjet alternative, në qoftëse janë të disponueshme, ndërsa gjithashtu do të jetë me rëndësi të konsiderueshme në plotësimin e kërkesave logjistike të vështira që janë rezultat i ngjarjes bioterroriste. Edhe pse logjistika nuk duhet të paraqesë probleme të rëndësishme gjatë orëve të para të reagimit, kërkesat në masë të madhe do të rriten me kalimin e kohës, sepse resurset harxhohen shumë më shpejtë se sa në punë normale.

Përfitimi nga planifikimi i përbashkët dhe ushtrimet për vlerësimin e efektivitetit të koordinimit, është se të gjitha subjektet e përfshirë të jenë më mirë të njohura njëra me tjetrën dhe me mundësi reciproke. Qasja efektive për komandimin, kontrollin, komunikimin dhe koordinimin duhet të jetë i përfshirë në planet për reagimin ndaj bioterrorizmit.

Këto komponenta janë kryesore për dizajnimin e reagimit efektiv, njëjtë si edhe identifikimi i sëmundjeve, dekontaminimi, kontrolli i përhapjes së infektimit dhe opsionet për trajtim.

Përfundim

Në kapitullin e parë sqaruar nocionin e sigurisë njerëzore. Së pari përshkruhet zhvillimi historik i idesë se individi duhet të jetë objekt i fundit i referencës të politikës së sigurisë. Megjithatë, në fund të Luftës së Ftohtë, kjo ide për diskursin e brendshëm politik tejkalon diskursin aktual ndërkombëtar, falë Kombeve të Bashkuara, si dhe të vendeve si Kanadaja, Norvegjia dhe Japonia. Në këtë kapitull pastaj është analizuar dallimi në mes kuptimit të brendshme (“liria nga frika”) dhe më të gjerë (“liria nga skamja”) të sigurisë njerëzore. Ndërsa aktorët që pranojnë përkufizimin e ngushtë, në kuadër të rrjetit për sigurinë njerëzore janë të udhëhequr nga Norvegjia dhe Kanadaja, aktorët që pranojnë përkufizimin më të gjerë janë të mbledhur në Komisionin Japonez për sigurinë njerëzore. Që të vendoset dialog në mes këtyre dy

shkollave të të menduarit, iniciativa e quajtur Miqtë e sigurisë njerëzore ishte ngritur në vitin 2006.

Zhvillimi i nocionit mjedis për sigurinë njerëzore nga mesi i viteve 1990 deri më sot, ka ndryshime thelbësore në diskursin politik ndërkombëtar. Nga njëra anë, nocioni i sigurisë botërore është “humanizuar”, nga ana tjetër, nocioni për të drejtat e njeriut dhe zhvillimi i njeriut është “sekuritarizuar”. Shfaqja dhe zhvillimi i këtij nocioni mundësuan së pari ruajtjen e faktorëve strukturorë, të tilla si dhënia fund e tensioneve të Luftës së Ftohtë duke zvogëluar tensionet ushtarake dhe politike në botë. Ato gjithashtu u mundësuan akademikëve të zgjerojnë nocionin e sigurisë. Përfundimisht siguria njerëzore është vendosur lartë në agjendën e OKB-së dhe në politikë botërore, më shumë falë interesave të fuqive të mesme si Kanadaja dhe Norvegjia.

Nocioni i është nënshtruar kritikave të shumta, duke filluar nga të qenit në mënyrë analitike e padobishme, përmes promovimit të ndërhyrjes, e deri sa u shndërrua në një dogmë të re e cila vetëm përforcon rendin ekzistues botëror të dominuar nga vendet e fuqishme të globit verior. Pavarësisht nga të gjitha, që nga publikimi i raportit për zhvillimin njerëzor në vitin 1994 e deri më sot, nocioni i sigurisë njerëzore është futur në teoritë dhe praktikën e sigurisë botërore.

Kritikat e forta akademike ndaj nocionit të sigurisë njerëzore nuk e ka penguar që siguria njerëzore të lëviz në frymën e politikës së jashtme dhe të sigurisë etike e cila është e bazuar në vlerat progresive dhe humaniste, dhe jo vetëm ato të interesave. A është kjo shprehje e re (sipas disa kritikëve) ose paradigmë e re e sigurisë, e cila ka potencial për emancipim të përhershëm në botë, mbetet të shihet.

Në kapitullin e dytë sqaruar kërcënimin hibrid dhe luftën hibride “Luftë ku armikun e njohim, por nuk e shohim”. Sipas disa hulumtimeve, termi për herë të parë në publik përmendet në punimin e Marinsave amerikan të botuar në vitin 1998, në të cilën aftësia për kryerjen e detyrave ekspedituese përshkruhet si “forcë hibride për luftë hibride” dhe “lufta e cila gjendet në udhëkryqin mes luftimit special dhe konvencional” me qëllim të përshkruhet kombinimi i forcave konvencionale dhe jo-konvencionale si mënyrë më efektive e përdorimit të resurseve ushtarake të kufizuara. Më vonë, në vitin 2002 termi përdoret gjatë studimit të lëvizjes separatiste çeçene dhe analizën e mjeteve për menaxhimin me veprimet e dhunshme, të “shoqërive të përzieria dhe hibride”. Veçanërisht është theksuar se luftimi hibrid do të bëhet dominues duke pasur parasysh se përdorë taktikë guerile dhe ushtritë moderne që janë të zhvilluara shumë në mënyrë burokratike dhe teknologjike

që do të ballafaqohen me shumë sfida. Në hulumtimin për “paraqitjen e luftërave hibride” në vitin 2007, paraqitet përkufizimi vijues: “grup i formave të ndryshme të luftimit duke përfshirë edhe aftësi konvencionale, taktika dhe formacione të parregullta, akte terroriste të dhunës dhe frikësimit dhe trazira kriminale”. Ky qëndrim menjëherë ndryshohet në vitin 2014 kur Rusia e aneksoi Krimenë dhe aktivitetet përshkruhen si diçka e re. Nga ana tjetër, Rusia për herë të parë përdori termin “luftim hibrid” në vitin 2016, të prezantuar nga Kryeshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral Valerij Gerasimov. Ai luftimin hibrid e karakterizon si luftim modern dhe përfshinë “revolucionet e larme” që kanë për qëllim të marrin vijat mes luftës dhe paqes. Ekziston edhe një term popullor që ka të bëjë me luftimin hibrid, zonë gri, shpesh e përshkruar si hapësirë konceptuale midis luftës dhe paqes. Që të përshkruhen konfliktet në zonën gri përdoren edhe terme tjera siç janë: lufta të vogla, konflikte me intensitet të ulët dhe operacione ushtarake jashtë luftës. Termi “hibrid” është pranuar që të përfshijë kompleksitetin e luftimit bashkëkohor, aktorët që janë të përfshirë dhe paqartësitë rreth kategorive të konflikteve. Paraqitja e kërcënimeve hibride paralajmëron zhvillim të rrezikshëm të aftësive të guerileve dhe forcave të parregullta që i shohim në konfliktet aktuale. Kërcënimet hibride kombinojnë forcat ushtarake konvencionale shtetërore, armët e tyre të sofistikuar dhe taktikat e tyre metribute që janë të lidhura me organizatat terroriste, rebele dhe kriminale.

Kërcënimet hibride janë kombinim i forcave të rregullta dhe të parregullta. Forcat e rregullta janë rregulluar me të drejtën ndërkombëtare, traditën dhe zakonet ushtarake. Forcat e parregullta janë të paligjshme dhe si rezultat i kësaj veprojnë pa kufizime në përdorimin e dhunës ose realizimin e qëllimeve me përdorimin e dhunës. Mundësia të kombinohet dhe të bëhet tranzicion midis forcave të rregullta dhe të parregullta i bën kërcënimet hibride më efektive. Që të jenë hibride, këto forca bashkëpunojnë në kontekst të realizimit të qëllimeve të tyre të brendshme. Për shembull, elementët kriminale mund të vjedhin teknikë ushtarake dhe pjesë për realizimin e profitit, ndërsa në të njëjtën kohë komprometojnë gatishmërinë e sistemeve luftarake të forcave të rregullta. Forcat e milicive mund të mbrojnë qytetin ose fshatin e tyre si pjesë e rrjetit defensiv kompleks. Disa kërcënimet hibride do të jenë rezultat i shtetit – sponsor të aktorit jo-shtetëror.

Kërcënimet hibride do të kërkojnë në favor të tyre ti përdorin mediumet, teknologjinë dhe pozicionin në infrastrukturën politike, ushtarake dhe sociale të shtetit në të cilin operojnë. Në veprimin e tyre kundër aleatëve perëndimor, operacionet e tyre do të jenë të adaptueshme, duke kombinuar

taktikat konvencionale, jo-konvencionale, neutrale, terroriste dhe kriminale në kombinime të ndryshme në kohë të ndryshme. Ato përmes aktiviteteve rrebeluese do të përpiqen të krijojnë jo-stabilitet dhe ti izolojnë forcat e rregullta nga popullsia. Në mënyrë shtesë, ato do të përdorin rrjete globale që të popullarizojnë ndikimin e tyre. Kërcënimet hibride nuk kanë kufizime në përdorimin e dhunës. Ato gjithashtu janë në mënyrë të përkryer të aftë për përdorimin e taktikave terroriste dhe guerile kur ajo u përshtatet. Aleatët perëndimor do të përballen me kërcënime hibride që njëkohësisht do të përdorin kombinim të caktuar të forcave të rregullta, të parregullta dhe elementet kriminale, që ti arrijnë qëllimet e tyre. Kërcënimet hibride kanë organizim fluid pajisje dhe taktika me çka në të ardhmen në mënyrë shtesë do të cenojnë mjedisin e sigurisë ndërkombëtare.

Në kapitullin e tretë sqaruam bioterrorizmin si metodë dhe formë e luftës hibride për cenimin e sigurisë njerëzore. Sipas Qendrës për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve në SHBA, bioterrorizmi përkufizohet si “lirimi i qëllimshëm i virusit, bakteve ose kërpudhave të cilët mund të infektojnë ose të vrasin njerëz, bagëti ose agrokulturë”. Gjithashtu, arma biologjike mund të “aktivizohet” edhe pas një periudhe të gjatë kohore, ndërsa autori ka kohë të ikë pa u zbuluar. Agensët biologjik dhe kimik mund të përhapen përmes ajrit, ushqimit ose ujit. Terroristët përdorin agensë biologjik, sepse ato janë të vështira për zbulim, ndërsa fillimi i sëmundjes mund të vonohet nga disa orë deri në disa ditë, duke rritur efektin e përhapjes. Agensët për bioterrorizëm janë zgjidhje e thjeshtë për terroristët, sepse ato janë të lehta dhe të lira për prodhim, të lehta për distribuim dhe mund të shkaktojnë efekte masive.

Sëmundjet e shkaktuara nga armët biologjike mund të grupohen në tre kategori. Klasifikimi bazohet në mundësinë e përhapjes, sëmundshmërisë dhe mortalitetit, potenciali i shkaktimit të panikës dhe nivelin e kërkesës nga sistemi shëndetësorë. Kategoria A: Sëmundje me prioritet më të madh që shkakton rrezik për sigurinë kombëtare, lehtë transferohet, kanë sëmundshmëri dhe mortalitet të lartë, do të ketë ndikim të madh për shëndetin e njerëzve dhe do të shkaktojnë panik, dhe kërkojnë gatishmëri të veçantë të sistemit shëndetësorë. Kategoria B: Viktima. Ky ndikim është i barabartë, ndërsa mund të tejkalojë rastin e sulmit me armë bërthamore. Sëmundje me prioritet të lartë që kanë potencial të shkaktojnë sëmundshmëri dhe mortalitet të konsiderueshëm, me shfaqjen e patogjeneve që mund të përhapen në mënyrë masive. Kategoria C: Sëmundje prioritare të matshme me sëmundshmëri dhe mortalitet të vogël që më vështirë përhapen. Sulmi biologjik efektiv mund të jetë shkatërrues, duke shkaktuar miliona viktima.

Përvojat me katastrofa reale dhe të simuluar, dëshmojnë se grupet mjekësore që paraprakisht kanë zhvilluar dhe kanë praktikuar plane të duhura, arrijnë reagim efektiv dhe koordinativ në situata me viktima masive. Kundrejt kësaj, reagimet e paplanifikuara në kohë rezultojnë me reagim të paorganizuar, joefikas, që dëmton të sëmurët ose personat e lënduar, dhe madje edhe mund të kontribuojnë edhe për viktima shtesë.

Dy skenare të ndryshme duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të reagimit ndaj bioterrorizmit. Së pari, pas sulmit biologjik të kryer në mënyrë sekrete, rezultati fillestarë do të jetë shfaqja e pacientëve të shqetësuar, në nivel lokal ose në lokacione të ndryshme në gjithë botën. Situata do të bëhet seriozisht e qartë, sepse më shumë persona do të kërkojnë ndihmë mjekësore. Kjo gjendje mundet shpejtë të zhvillohet në situata me viktimize në masië. Megjithatë, nëse njihet në kohë, do të kursehet kohë që të organizohen resurset për mbrojtje shëndetësore në bashkësinë dhe të zbatohet plan për reagim ndaj bioterrorizmit. Në skenarin e dytë, me sulm bioterrorist të paralajmëruar, numër i madh i personave do të kërkojnë ndihmë mjekësore dhe trajtim urgjent për kohë të shkurtër. Përgjegjësia e institucioneve mund të prolongohet deri sa studimet laboratorike nuk vërtetojnë se a ka ndodhur sulm i vërtetë. Çdo prolongim mund të rezultojë në çrregullimin serioz të shëndetit të viktimizeve, ndërsa edhe me pasoja tjera në ngjarje reale. Përveç vlerësimit dhe trajtimit të lënduarve, do të jetë e nevojshme edhe dokumentimi.

Literatura

- 1) A Human Security Doctrine for Europe: The Barcelona Report of the Study Group on Europe's Security Capabilities, 4, <www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/.../040915capbar.pdf
- 2) Buzan, 2004, 369; Chandler, 2008
- 3) Bachmann, S.-D. & Gunneriusson, H. „Hybrid wars: the 21st-century's new threats to global peace and security“, *Scientia Militaria, South African Journal of Military Studies, Vol. 43, No. 1, 2015*
- 4) Bridget Johnson, „ISIS Lauds ‘Death and Terror’ of Coronavirus Outbreak“, *Homeland Security Today, January 27, 2020*
- 5) Commission on Human Security, *Human Security Now* (New York, 2003), 4, <http://www.humansecurity-chs.org/finalreport/English/FinalReport.pdf>

- 6) Derbes VJ. „de Mussis and the great plague of 1348“, JAMA, 1966
- 7) DFAIT, 2002, <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N00/399/03/PDF/N0039903.pdf?OpenElement>
- 8) Danzing R., „Catastrophic Bioterrorism: What Can Be Done?“ Washington, D.C.: Center for Technology and National Security Policy, 1998
- 9) David J. Dausey, Nicole Lurie, Alexis Diamond, Barbara Meade, Roger Molander, Karen Ricci, Michael Stoto, Jeffrey Wasserman „Bioterrorism Preparedness Training and Assessment Exercises for Local Public Health Agencies“, RAND Corporation, 2005
- 10) Ejuds F., Megunarodna Bezbednost: Teorije, Sektori i Nivoi, Beograd, 2012
- 11) Gary H. Cheek, “Effects-Based Operations: The End of Dominant Maneuver,” in Transformation Concepts for National Security in the 21st Century, Carlisle Barracks, PA: Strategic Studies Institute, U.S. Army War College, September 2002
- 12) ICISS, Responsibility to Protect (Ottawa, december 2001), <http://www.iciss.ca/pdf/Commission-Report.pdf>
- 13) Ian Reader, „A POISONOUS COCKTAIL? Aum Shinrikyô’s Path to Violence“, NIAS – Nordic Institute of Asian Studies, NIAS Press, 2011
- 14) Jane Buchanan, „Up in Flames: Humanitarian Law Violations and Civilian Victims in the Conflict Over South Ossetia“, Human Rights Watch (Organization), Human Rights Watch, 2009
- 15) Johns Hopkins University - Center for Civilian Biodefense Studies, „Anthrax“, Johns Hopkins Public Health Magazine, 2001
- 16) Lisa Idzikowski, „Chemical and Biological Warfare“, Greenhaven Publishing LLC, 2019
- 17) MacFarlane and Khong, 2006
- 18) Prof.Dr.Muhamet Racaj, Luftë ku armikun e njohim por nuk e shofim-Lufta hibride, Bota sot, 16.04.2020
- 19) Mollie Williams; Lisa Armstrong; Daniel C. Sizemore., „Biologic, Chemical, and Radiation Terrorism Review“, StatPearls Publishing LLC, 2020
- 20) Д-р Ненад Танески; Биотероризам; Штит бр.129 fq. 24-27, Prill, 2020
- 21) Rezoluta 1674 KS KB, <http://daccessddsny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N06/331/99/PDF/N0633199.pdf?OpenElement>

- 22) The Causes of Conflict and the Promotion of Durable Peace and Sustainable Development in Africa: Report of the Secretary General (13. april 1998), <http://www.un.org/ecosocdev/geninfo/afrec/sgreport/main.htm>
- 23) Thomas Huber, "Compound Warfare: A Conceptual Framework," in *Compound Warfare: That Fatal Knot*, ed. Thomas M. Huber (Fort Leavenworth, KS: U.S. Army Command and General Staff College Press, 2002)
- 24) UNDP, Human Development Report 1993, <http://hdr.undp.org/en/reports/global/hdr1993/chapters/>
- 25) Vassil St. Georgiev,, National Institute of Allergy and Infectious Diseases, NIH: Volume 2: Impact on Global Health“, Springer Science & Business Media, 2009



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

BIZNESI

Revistë shkencore për çështje
Ekonomike,
Juridike,
Emergjence e sigurie

Scientific journal on issues
Economic,
Law,
Emergency and security

**Viti -X-
Nr. 20-21**

Botohet çdo gjashtë muaj / Published every six months